



Pranuar / Dorezuar Primeshë / Prodato Received / Delivery	04.11.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBEK	6747/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.899/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.899/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër Vendimit me Nr. 29640 të datës 14.09.2022 të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti në Komunën e Kamenicës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore vërejtje me shkrim, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.899/2022 e datës 12.10.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. ANULOHET masa disiplinore „Vërejtje me shkrim“ e shqiptuar ndaj ankuses [redacted] sipas Vendimit me Nr. 29640 të datës 14.09.2022 nga Drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti në Komunën e Kamenicës.

III. OBLIGOHET Kryetari dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuses në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses [redacted] e punësuar në pozitën "Zyrtare për Sport" në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës, me datë 14.09.2022 Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës ka nxjerr Vendim me Nr. 29640 me te cilin i ka shqiptuar "vërejtje me shkrim", me dyshimin se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, lidhur me mos respektimit të orarit të punës gjegjësisht me arsyetimin se e njëjta nuk ishte në vendin e punës dhe për këtë mungesë nuk kishte leje apo ndonjë arsye tjetër për mos qenë prezent në vendin e punës.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 29640 të datës 14.09.2022 të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Kamenicës lidhur masës disiplinore vërejtje me shkrim, përmes emailit ankesa.kmpshck@rks-gov.net, më datë 12.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë është regjistruar nën shenjë A.nr.899/2022 me numër protokollit 6119/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.10.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Kamenicës. Ndërsa Këshilli më datë 26.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.10.2022 e regjistruar me numër protokollit 6119/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 29640 të datës 14.09.2022 të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Kamenicës lidhur masës disiplinore vërejtje me shkrim; Raport mjekësor nga Ordinanca Specialistike GASTRO i datës 12.09.2022, 13.09.2021, Test Raport nga BIO-LAN i datës 17.03.2021 Raport mjekësor nga Laboratori Histopatologjik dhe Citologjik DRENI me Nr. 84/21-3 i datës 17.03.2021; Raport nga KONETIKA i datës 10.02.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.10.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 26.10.2022; Akt Emërimin e datës 15.09.2011; Aktvendim me Nr. 112 i datës 25.02.2010; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.12.2019 dhe 01.02.2021; Organogrami i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Emailin e datës 04.10.2022 nga [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, *është e bazuar, SEPSE:*

Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës me datë 14.09.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 29640 me te cilin ankueses [redacted] e cila mban pozitën "Zyrtare për Sport" në Sektorin për Sport në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, i ka shqiptuar "vërejtje me shkrim", nën dyshimin e bazuar se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Rregullores (QRK)Nr.11/2020 për



Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, lidhur me mos respektimin e orarit të punës gjegjësisht me arsyetimin se e njëjta nuk ishte në vendin e punës dhe për këtë mungesë nuk kishte leje apo ndonjë arsye tjetër për mos qenë prezent në vendin e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se shqiptimi i masës disiplinore "vërejtje me shkrim", me datë 14.09.2022 nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës i është shqiptuar nga personi jo kompetent respektivisht nuk i është shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe po ashtu e njëjta pretendon se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë nen 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", e mbi këtë bazë ligjore rrjedh se Drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti në Komunën e Kamenicës nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "vërejtje", sepse në bazë të provave materiale lidhur me çështjen në procedurë përkatësisht sipas Formularit për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.12.2019 dhe 01.02.2021 mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankueses është "Përgjegjësi për Sport" në këtë rast.*

kjo argumentohet edhe sipas organogramit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe përveç kësaj edhe nga emaili i datës 04.10.2022 i Drejtoreshës e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti në Komunën e Kamenicës e cila ndër të tjera thekson se: "...duke pas parasysh që as udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë nuk ka qenë në zyrë në orarin e punës, jam detyruara që në cilësinë e drejtorit të drejtorisë të shqiptoj masën". Andaj nisur nga ky konstatim rrjedhë së është i bazuar pretendimi ankimor i ankueses mbi këtë bazë.

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nuk u lëshua në konstatimet e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryetari dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuese në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në diapozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.899/2022.

Avdyll BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.